

Në bazë të nenit 38, paragrafi 1, pika 2 e në lidhje me nenin 27, paragrafi 1, pika 1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (“Gazeta Zyrtare e Malit të Zi” nr. 2/18, 34/19, 38/20, 50/22 dhe 84/ 22), nenin 14 të Ligjit për Veprimtaritë Komunale (“Gazeta Zyrtare e Malit të Zi” nr. 55/16, 74/16, 02/18 dhe 66/19) dhe nenin 58, paragrafi 1, pika 2 të Statutit të Komunës së Ulqinit (“Gazeta Zyrtare e Malit të Zi – dispozitat komunale”, nr. 48/19), Kuvendi i Komunës së Ulqinit në seancën e mbajtur më 28.12.2022, miratoi

VENDIMIN

PËR NDRYSHIMET DHE PLOTËSIMET E VENDIMIT PËR RENDIN KOMUNAL

Neni 1

Në Vendimin për rendin komunal (“Gazeta Zyrtare e Malit të Zi – dispozitat komunale”, nr. 27/19) neni 87 ndryshohet si vijon:

Ndalohet edhe kryerja e të gjitha punimeve të truallit, zejtare, ndërtimore dhe punimeve për sanimin, ndërtimin, shtimin dhe heqjen e strukturës së objektit gjatë zgjatjes së sezonit turistik në zonën e qytetit të Ulqinit, nga ora 00:00 deri në orën 24:00, në pjesët që përfshijnë zonat e mëposhtme:

Zona e parë përfshin qendrën e qytetit bulevardin “Gjergj Kastrioti Skënderbeu”, rrugën “Ali Riza Ulqinaku” dhe vendbanimet Mali i Bardhë, Ranë, Kala, Liman, Mëhalla e Re, Meteriz dhe Pinjesh.

Në zonën e parë, ndalimi i përkohshëm i ndërtimit fillon nga data 1 qershor deri më 15 shtator të vitit vijues.

Zona e dytë përfshin pjesë të tjera të qytetit të Ulqinit dhe zonat periferike që nuk përfshihen në zonën e parë Krruç, Plazhi i Madh, Shtoj e të tjera.

Në zonën e dytë, ndalimi i përkohshëm fillon nga data 10 qershor deri më 15 shtator të vitit vijues.

Neni 2

Neni 135 ndryshohet si vijon:

Me gjobë në shumë prej 500,00 € deri në 10.000,00 € do të dënohet për kundërvajtje ushtruesi i veprimtarisë komunale, nëse:

1. - nuk mirëmban objektet dhe pajisjet komunale në gjendje të saktë, të rregullt dhe të pastër (neni 8);

2. - nuk mirëmban pastërtinë në hapësirat publike në kuadër të programit të përcaktuar të mirëmbajtjes së pastërtisë (neni 17);

3. - nuk miraton programin e mirëmbajtjes së pastërtisë (neni 20);

4. - nuk vendos numër të mjaftueshëm koshash për grumbullimin e mbeturinave (neni 21);

5. - nuk zbraz rregullisht dhe nuk mirëmban koshat e mbeturinave në gjendje të rregullt higjienike, si dhe hapësirën përreth tyre (neni 22);

6. - lëndët dhe lëngjet e djegshme dhe të dëmshme që nuk konsiderohen mbeturina shtëpiake i shkarkon në deponi (neni 25);

7. - mbeturinat shtëpiake nuk grumbullohen sipas programit të grumbullimit të mbeturinave (neni 36);

8. – gjatë grumbullimit të mbeturinave shtëpiake nuk kujdeset që mbeturinat të mos shpërndahen, të mos çohet pluhur dhe të mos krijohet zhurmë, të mos dëmtohen koshat e mbeturinave, si dhe sipërfaqet në të cilat ndodhen koshat (neni 39);

9. - nuk kujdeset për rregullimin, mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e sipërfaqeve të gjelbra publike (neni 48);

10. - nuk mban evidencë për gjendjen e sipërfaqeve të gjelbra publike, të materialit bimor, të objekteve, pajisjeve dhe inventarit në këto sipërfaqe (neni 50);

11. - nuk rregullon sipërfaqet e gjelbra në përputhje me dokumentacionin planifikues dhe projektin e gjelbërimit sipas pëlqimit paraprak të marrë nga organi kompetent (neni 49);

12. - nuk kosit rregullisht vendet me bar, nuk mirëmban shtigjet dhe parqet, nuk krasit pemët dhe gjerdhet, nuk merr masa për mbrojtjen e gjelbërimit nga sëmundjet dhe dëmtuesit e bimëve, nuk përtërinë gjelbërimin pas fatkeqësive natyrore, nuk mbledh dhe largon barin, gjethet e të tjera. (neni 53);

13. - vepron në kundërshtim me atë që parashikohet në nenin 56 të këtij vendimi;

14. - nuk ruan dhe nuk mbron gjelbërimin (neni 56);

15. - nuk largon nga sipërfaqja e gjelbër publike drunj ose pjesë të drunjve që janë tharë, vjetërsuar dhe dëmtuar nga fatkeqësitë natyrore, nëse ata rrezikojnë jetën e njerëzve, mbarëvajtjen normale të trafikut ose rritjen normale të drunjve përreth (neni 63);

16. - nuk mirëmban ndriçimin publik në përputhje me programin e mirëmbajtjes (neni 108);

17. - nuk mirëmban krojet publike (neni 111);

18. - nuk largon kafshët e ngordhura dhe të aksidentuara nga hapësirat publike dhe nuk i asgjëson në mënyrën e përcaktuar (neni 26);

19. - pas njoftimit të marrë nga Inspektorati Komunal ose Policia Komunale nuk largon nga sipërfaqja publike bagëtinë, pronari i së cilës nuk dihet, e që rrezikon sipërfaqen publike (neni 121);

20. - pas zbrazjes së gropës septike nuk bënë dezinfektimin e hapësirës ku ndodhi derdhja e ujërave të zeza (neni 129, paragrafi 2);

21. - nuk kujdeset për mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e kanalizimit atmosferik (neni 130, paragrafi 2);

Për kundërvajtje nga paragrafi 1 i këtij neni, dënohet me gjobë në shumë prej 50,00 € deri në 500,00 € personi përgjegjës i ushtruesit të veprimtarisë komunale.

Neni 3

Neni 136 ndryshohet si vijon:

Me gjobë në shumë prej 500,00 € deri në 10.000,00 € do të dënohet për kundërvajtje personi juridik, nëse:

1. nuk mirëmban në gjendje të rregullt hapësirën dhe oborrin përreth objektit të banueshëm dhe afarist, nuk mirëmban objektet dhe pajisjet komunale, ndynë dhe dëmton sipërfaqet publike, shkarkon mbeturinat inerte dhe të lëngshme në shtretërit e lumenjve dhe rrjedhat ujore, vendos sende në sipërfaqe publike dhe kryen punime pa miratimin e organit kompetent, largon, zhvendos dhe pa miratim vendos objektet dhe pajisjet komunale (neni 6);

3. nuk i mirëmban në gjendje të rregullt pjesët e jashtme të ndërtesës (fasadat, ballkonet, vitrinat, dyert, dritaret, ulluqet, vitrinat ekspozuese, rrethojat), kopshtet dhe pjesët e oborrit të dukshme nga sipërfaqet publike (neni 7);

4. nuk ruan pastërtinë e sipërfaqeve dhe hapësirave (të gjitha sipërfaqet dhe hapësirat jashtë sipërfaqeve publike) që administrojnë apo përdor (neni 18);

5. nuk lidh kontratë për grumbullimin e mbeturinave me ushtruesin e veprimtarive komunale (neni 19);

6. nuk pastron dhe lanë sipërfaqet publike përpara kantierit të ndërtimit, nuk lag materialet e shkrifëta gjatë rrënimit dhe transportit, si dhe rrugët hyrëse, për të parandaluar çuarjen e pluhurit jashtë kantierit të ndërtimit, nuk pastron baltën nga rrotat e automjeteve para daljes së tyre nga kantieri i ndërtimit në rrugën komunale ose sipërfaqen publike apo nuk pastron sipërfaqen publike të ndyrë me baltë, nuk e largon materialin pas rrënimit të objektit brenda 48 h nga përfundimi i punimeve, nuk e rrethon kantierin e ndërtimit në mënyrën e parashkruar (neni 22);

7. brenda 24 h pas shkarkimit të materialeve djegëse, të ndërtimit dhe të tjera, nuk e liron sipërfaqen publike nga materiali në fjalë dhe më pas të njëjtën nuk e pastron dhe nuk e lan (neni 23);

8. në sipërfaqe publike hedh letër dhe mbeturina të tjera jashtë koshave për grumbullim të mbeturinave, derdh ujëra të zeza dhe papastërti të tjera, mban mbeturina në tokë, lan automjete dhe copëton dru, vendos reklama, njoftime, materiale propaganduese dhe të ngjashme; në koshin e mbeturinave hedh prush dhe derdh ujë, materie të dëmshme dhe të nderzshme, lëngje ose mbeturina që nuk i përkasin mbeturinave shtëpiake, shkarkon dheun, mbeturinat dhe materialet të ndërtimit, zhavorrin, rrënojat, ambalazhet dhe mbeturina të tjera jashtë deponive, zë hapësirën publike për sistemim të mallrave, lëndëve djegëse, tezgave të lëvizshme për shitjen e mallrave, ambalazhit, për vendosje të tavolinave, karrigeve apo stolave dhe pajisjeve të tjera, zë hapësira publike duke vendosur shtylla, rampa, rrethoja, duke riparuar automjete, duke lënë automjete të paregjistruara dhe të dëmtuara, rimorkio kampimi e të tjera (neni 25);

9. nuk mban mbeturinat shtëpiake në kosha të rregullt higjienik (neni 38);

10. kondicionerët i vendos në pjesën e jashtme të ndërtesave në kundërshtim me dispozitat e nenit 27.

11. nuk kujdeset për mirëmbajtjen e kolektorit për trajtimin e ujërave të zeza (neni 29);

12. nuk e heq borën dhe akullin nga stacionet e autobusëve, qendrat tregtare të hapura, objektet sportive (neni 65);

13. nuk e pastron borën nga rrugët hyrëse dhe shtigjet që përdor dhe nuk i trajton me materialin e duhur në rast ngrice, nuk e pastron borën dhe akullin nga çatia e ndërtesës, nëse bora ose akulli paraqet rrezik për kalimtarët ose ndërtesën; kontraktori dhe investitori nuk pastrojnë borën dhe nuk e trajtojnë trotuarin me materialin përkatës përpara objektit në ndërtim, nuk e heq akullin nga pjesa e jashtme e objektit, nuk i vendos në kohë shenjat përkatëse paralajmëruese ndaj rrezikut nga rënia e borës nga çatia e ndërtesës, kur pronari nuk mund ta heqë vetë atë (neni 66 dhe 57);

14. kur e pastron borën dhe akullin, i hedh në trotuar ose në rrugë (neni 38);

15. nuk i përdor sipërfaqet e gjelbra publike për qëllimet e përcaktuara (neni 54);

16. përdor sipërfaqe të gjelbra publike për: drejtim të çdo lloji automjeti, parkim dhe larje të mjeteve, ndezje të zjarrit, djegie të drunjve dhe gjetheve, shkarkim të materialeve, mallrave, ambalazhit e të tjera, rrëmim ose çelje të gropave, kanaleve, riparim të automjeteve motorike, shkulje dhe prerje të drunjve pa pëlqimin e organit kompetent, dëmton drunj dhe të mbjella të tjera, heq, shkatërron dhe dëmton udhëtregues, shenja të komunikacionit, dëmton shtigje, stola, kosha të mbeturinave, ngjitje në pemë, instalime, rrethoja ose objekte të tjera, vendosje të objekteve të përkohshme, pajisjeve dhe mjeteve pa pëlqimin e organit kompetent, shkundje ose larje të tapetave, hedhje të letrës dhe të mbeturinave, kamping, përdorim të vendeve me bar jashtë qëllimit të përcaktuar, gjërmim dhe marrjen të dheut, gurëve, rërës, lëshim të kafshëve shtëpiake e të tjera (neni 56);

17. vë rrethoja në oborre dhe kopshte, si dhe në vende të tjera në zonën e qytetit dhe të vendbanimeve me karakter qytetor, pa pëlqimin e organit kompetent (neni 57);

18. nuk mban oborr të rregullt dhe të pastër të objekteve të banueshme dhe afariste (neni 77);
19. Në fasadë të objektit ngjet shpallje, pllakate, banderola dhe materiale të tjera propaganduese, ndryshon pamjen e jashtme të ndërtesës, vendos dhe heq xhamin në ballkone; në dritare, dyer, ballkone, rrethoja dhe pjesë të tjera të objektit vendos konstruksione metalike dhe të tjera, pa pëlqimin e organit kompetent (neni 82);
20. bënë punime në sipërfaqe publike pa pëlqimin e organit kompetent (neni 84);
21. rezervon vendin e parkimit në parking duke vendosur shenjë të komunikacionit ose në mënyrë tjetër (neni 93);
22. vetë i cakton emrat e rrugëve dhe shënon objektet me numra (neni 96);
23. në hyrje të lokalit afarist nuk e ka të shkruar qartë emrin e firmës (neni 97);
24. nuk mirëmban në gjendje të rregullt mbishkrimet dhe reklammat me dritë (neni 98);
25. nuk vendos pllakate, shpallje, njoftime, banderola dhe mbishkrime të tjera në shtylla, pano dhe bilborde reklamuese, si dhe në objekte të tjera të ngjashme në pajtim me Programin e objekteve të përkohshme (neni 102);
26. nuk heq mbishkrimin shpallës – reklamues nga objekti reklamues brenda 3 (tre) ditëve nga përfundimi i ngjarjes së cilës i referohet mbishkrimi reklamues (neni 106);
27. lan automjete, rroba dhe sende të ngjashme në krojet dhe shatërvanët publikë dhe përdor ujin për ujitje të kopshteve, larje të rrugëve, oborreve dhe objekteve afariste (neni 114);
28. mban bagëti dhe shpendë të imët dhe të mëdhenj në kufijtë e Planit detaj urbanistik të Komunës së Ulqinit (neni 118);
29. lëshon bagëti në rrugë, shëtitore, tregje, vende me bar në rrugë, parqe, parkingje, stacione të autobusëve, terrene sportive, ndërmjet dhe përreth ndërtesave (neni 118 paragrafi 3);
30. mban kafshë shtëpiake në mënyrën që prish rendin dhe qetësinë publike, pastërtinë në hapësira të përbashkëta të objektit të banueshëm dhe në qytet (neni 120 paragrafi 1);
31. mban raca të ndaluara të qenve (neni 120, paragrafi 2 dhe 3);
32. nxjerr qentë në sipërfaqe të gjelbra publike të rregulluara si lulishte ose vende me bar, kënde lojërash për fëmijë dhe fusha sportive, shtigje sportive dhe rekreative e të tjera; shtie kafshët shtëpiake në objekte publike (objekte administrative, objekte postare dhe telekomunikuese, banka, objekte shëndetësore, objekte për mbrojtjen sociale dhe të fëmijëve, objekte sportive, objekte edukuese dhe arsimore dhe objekte tjera të ngjashme) (neni 120, paragrafi 4);
33. shet mallra në hapësira publike dhe vendos stenda për ekspozimin e materialeve për qëllime reklamuese, pa pëlqimin e organit kompetent (neni 25);
34. ndërton dhe/ose vendos objekte dhe pajisje të përkohshme dhe objekte ndihmëse në sipërfaqe publike dhe të tjera, në kundërshtim me dispozitat e nenit 72 të këtij vendimi;
35. nuk ndërton gropë septike sipas rregullave sanitare dhe teknike, e në bazë të vendimit të lëshuar nga organi kompetent, dhe nuk zbrazë atë në kohë të duhur (neni 123);
36. pas zbrazjes së gropës septike nuk bënë dezinfektimin e hapësirës ku ndodhi derdhja e ujërave të zeza (neni 124);
37. bënë lidhjen e gropës septike me kanalizimin atmosferik (neni 130);
38. ngushton profilet tërthore të kanaleve dhe tuneleve të ujërave atmosferik, bënë mbushjen ose ndërprerjen e tyre (neni 130 paragrafi 2);
39. nuk i mirëmban kanalet e ujërave atmosferik që kalojnë nëpër pronën private të pronarit të asaj prone (neni 130 paragrafi 3);
40. shkarkon fekale, acide, alkale, kripëra të ndryshme, benzinë, vaj, yndyra dhe substanca të tjera në kanalizimin atmosferik të rrugës, të cilat mund të dëmtojnë materialin nga i cili është ndërtuar kanalizimi atmosferik, hedh mbeturina, hi, eshtra, çimento, rërë dhe sende të tjera që mund ta dëmtojnë objektin e kanalizimit atmosferik (neni 130 paragrafi 4);

41. lidh objektet në mënyrë arbitrare me ujëra të zeza atmosferike (neni 109);
42. prish rendin komunal duke krijuar zhurmë, me përdorim të pajisjeve akustike, elektroakustike ose mekanike dhe pajisjeve për ftohje - ngrohje, respektivisht ajrim të objekteve gastronomike dhe objekteve të banueshme dhe banesoro-afariste (neni 130, paragrafi 5);
43. Kryen punime në zonat ku ndalohet kryerja e të gjitha punimeve të truallit, zeytare, ndërtimore dhe punimeve për sanimin, ndërtimin, shtimin dhe heqjen e strukturës së objektit gjatë zgjatjes së sezonit turistik në zonën e qytetit të Ulqinit, nga ora 00:00 deri në orën 24:00 (neni 87).
- Për kundërvajtje nga paragrafi 1 i këtij neni, personi përgjegjës në personin juridik dënohet me gjobë në shumë prej 200,00 € deri në 500,00 €.
- Për kundërvajtje nga paragrafi 1 i këtij neni, sipërmarrësi dënohet me gjobë në shumë prej 300,00 euro deri në 2.000,00 euro.
- Për kundërvajtjet nga paragrafi 1 i këtij neni, përveç për kundërvajtjet e përcaktuara në pikat 5, 6, 10, 11, 22 dhe 23, personi fizik dënohet me gjobë në shumë prej 150,00 € deri në 500,00 €.

Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e publikimit në "Gazetën Zyrtare të Malit të Zi – dispozitat e komunës".

KUVENDI I KOMUNËS SË ULQINIT

Numër 02-016/22-553-6
Ulqin, më 28.12.2022

KRYETARI
Ardijan Mavriq